



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_г./в.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në vazhdimin e seancës së 54-të, të mbajtur më datë 02.11.2021 morri,

## VENDIM

Procedura për lëndën me nr. 12 - 1522 nga viti 2021, e formuar me vetiniciativë të KSHPK-së, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për arsye se pohimet nuk janë vërtetuar.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-1522 nga viti 2021 është formuar me vetiniciativë të KSHPK-së, dhe në bazë të zërit të mediave lidhur me pohimet e publikuara për dyshime në ligjshmërinë e procedurës së prokurimit publik në të cilën kompania "-----", në pronësi të partnerit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, -----, ka lidhur marrëveshje me Qytetin e Shkupit në vlerë prej një milion denarë për filmime me dron në sipërfaqet pyjore në luginën e Shkupit për zbulimin e hershëm të sëmundjeve të bimëve.

Me qëllim të verifikimit të pohimeve të publikuara në media, KSHPK-ja i dërgoi kërkesë Qytetit të Shkupit për të dhënë të dhëna dhe informacione lidhur me pohimet në fjalë. Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit të pranuar, KSHPK-ja konstatoi gjendjen faktike në vijim:

1) Në rastin konkret bëhet fjalë për procedurë të prokurimit publik të zbatuar nga organi kontraktues i Qytetit të Shkupit për blerjen e shërbimit për marrjen me qira të pajisjeve për monitorimin e lartësive të sipërfaqeve pyjore në luginën e Shkupit për zbulimin e hershëm të sëmundjeve të bimëve (dron). Është përzgjedhur kompania ----- me të cilën është lidhur kontrata për prokurimin në fjalë. Prokurimi është planifikuar me planin vjetor të prokurimit publik për vitin 2020 të Qytetit të Shkupit dhe është i publikuar në ueb faqen e SEPP.

2) Nga ana e Kryetarit të Komunës ishte marrë Vendim për Prokurim Publik me të cilin është përcaktuar vlera e përgjithshme e parashikuar e prokurimit prej 847.458,00 denarë pa TVSH, duke zbatuar procedurë të hapur të thjeshtuar përmes ESPP-së dhe duke përdorur ankand elektronik. Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit ishte çmimi më i ulët. Me vendim është formuar komisioni për kryerjen e prokurimit publik.

- Shpallja për prokurim publik është publikuar në SEPP me datë 11.12.2020 me numër 18812/2020 dhe në Gazetën Zyrtare të RM-së me numër 294 nga 11.12.2020.

- Është përgatitur dokumentacioni i thjeshtuar i tenderit për dhënie të kontratës së prokurimit publik nga dhjetori 2020 në të cilin kushtet për përzgjedhje cilësore të operatorëve ekonomikë dhe kriteret për përcaktimin e aftësisë dhe kriterin për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme përputhen me Vendimin e miratuar. Pjesë

përbërëse e dokumentacionit të tenderit është Specifikimi Teknik i pajisjeve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve.

- Është përgatitur procesverbali me datë 28.12.2020, i nënshkruar mirë në të cilën është regjistruar se është dorëzuar vetëm një ofertë të vlefshme nga kompania ----- me dokumentacion të nevojshëm dhe ofertë financiare në vlerë prej 70.000,00 denarë për kilometër katror pa TVSH.

- Kryetari i Qytetit të Shkupit, kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Prokurim Publik të Qytetit të Shkupit nënshkruan deklarata për mos ekzistencën e konfliktit të interesit.

- Raporti ishte përgatitur për procedurën e zhvilluar në të cilin është vlerësuar vetëm oferta e pranuar dhe është dhënë propozim për përzgjedhjen e ofertuesit.

- Kryetari i Qytetit të Shkupit mori Vendim për zgjedhjen e ofertës më të favorshme me të cilin në procedurën lëndore të prokurimit publik u zgjodh oferta e ofertuesit -----.

- Është lidhur kontrata me datë 04.03.2021 në vlerë të përgjithshme prej 847.458,00 denarë pa TVSH, në përputhje me çmimin e vetëm të ofruar për fluturimet hapësinore për kilometër katror në territorin e qytetit.

- Qyteti i Shkupit, me datë 22.12.2020, i lëshoi ofertuesit SHPTU ----- i dha certifikatë për zbatimin e suksesshëm dhe cilësor të kontratës.

Krahas përgjigjes nga Qyteti i Shkupit, është dorëzuar edhe dokumentacioni nga procedura e prokurimit publik të zhvilluar në vitin 2019, për blerjen e shërbimeve për marrjen me qira të pajisjeve për mbikëqyrje në terren të deponive ilegale dhe zonave të tjera të qytetit, ku përfshihet edhe kompania e përzgjedhur.----- dhe është lidhur kontratë me datë 09.05.2019 në vlerë prej 820.000,00 denarë pa TVSH.

Nga e lartpërmendura, KSHPK-ja përcaktoi se në rastin konkret bëhet fjalë për procedurë të prokurimit publik të paraparë me Planin Vjetor të Prokurimit Publik të Qytetit të Shkupit për vitin 2020, procedura për dhënien e kontratës është zhvilluar si procedurë e hapur e thjeshtësuar përmes SEPP-së duke përdorur ankandin, në të cilin është paraqitur një ofertues me të cilin është lidhur kontrata e prokurimit publik brenda vlerës totale të parashikuar të prokurimit. Për më tepër, Qyteti i Shkupit ka realizuar marrëveshje me të njëjtën kompani në vitin 2016 kur ----- nuk ka qenë ministër në Qeveri dhe nuk ka mundur të ndikojë në zgjedhjen e kompanisë të ortakut të saj.

Nga e lartpërmendura, KSHPK konstatoi se pohimet nuk janë vërtetuar dhe ka vendosur si në dispozitën e këtij vendimi.

**KOMISIONI SHITETËROR  
PËR PARANDALIMIN E  
KORRUPSIONIT**  
Kryetar,  
**Biljana Ivanovska**

Punoi: J.C.  
Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së